



Prishtinë, 06 shtator 2013
Kodi i ZRRE-së: V_559_2013

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, 5 dhe 13 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja; dhe
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, në lokacionin WindPark - Krajkova, me kapacitet të instaluar prej 21 MW, komuna e Drenasit, të datës 26.02.2013 të ndërmarrjes “Era Energji” SH.P.K., me adresë “H.Dynan C15-H 3/9 – Prishtinës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 06 shtator 2013 nxori këtë:

V E N D I M

Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar

- I.** Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) konstaton se ndërmarrja “Era Energji” SH.P.K., ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Era, në lokacionin WindPark - Krajkova, me kapacitet të instaluar prej 21 MW, komuna e Drenasit.
- II.** Aplikantit “Era Energji” SH.P.K., mund t’i lëshohet **AUTORIZIMI** për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenet 14 dhe 15 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.
- III.** Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të fillojë ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese para se t’i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën II. të këtij Vendimi.
- IV.** Vendimi mbi njoftimin për autorizimin preliminar, i lëshohet ndërmarrjes “Era Energji” SH.P.K., për dy (2) vite, dhe obligohet që brenda kësaj periudhe të bëjë kërkesë me shkrim duke kërkuar që ti lëshohet Autorizimi për ndërtim të stabilimenteve të reja gjeneruese nga Era.

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 26.02.2013 nga ndërmarrja “Era Energji” SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë



elektrike nga Era, në lokacionin WindPark - Krajkova, me kapacitet të instaluar prej 21 MW, komuna e Drenasit.

- ZRRE, pas vlerësimit të dëshmive të bashkangjitura aplikacionit dhe pranimt të dëshmive tjera plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

V. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar.